

# **Piçkaminet e Sa` Lluçisë**

**Piçkaminet janë yliz  
çë i bëjnë dritë natës.  
Piçkaminet janë gjuhë zjarri  
çë ngrohën zemrat e gjitonitë.  
Piçkaminet janë Kullure të çuditshëm  
çë të sjellën lligri.  
Per Tij, o` Sa` Lluçit,  
gjindja vete ture kërkuar  
dru, fascina, dega  
ndëpër male, vreshta e kopshtira;  
sa t` e bëjnë  
saroin më të mathë.  
Kur piçkaminet dhezën,  
një bukuritë pathënëshme  
na buthohet:  
Frasnita, te` kjo natë pjetë magji  
e tërë dritësohet:  
një bërrilok na duket!**